



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 2/10, DATË 04 / 02 /2021

PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE PARAPRAKE NGA SUBJEKTI "AL SHIDDI TRADING COMPANY" LTD, SHOQËRI E SË DREJTËS ARABE, ME NUMËR REGJISTRI THEMELTAR 1010235319 DHE "SHIDDI GROUP" SH.P.K, SHOQËRI E REGJISTRUAR SIPAS SË DREJTËS SHQIPTARE ME NUIS/ NIPT L92202023J, SIPAS VENDIMIT NR.2/7 DATË 27.07.2020 TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE “PËR MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “TIRANA CITY CENTER” PROPOZUAR NGA SUBJEKTI "AL SHIDDI TRADING COMPANY" LTD DHE "SHIDDI GROUP" SH.P.K.

Në mbështetje të Nenit 8, 9, 15, 17, 18, 22 , 25 dhe 30 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për miratimin e projekteve me statusin “Projekt me Potencial Strategjik”; Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1028, datë 16.12.2015 “Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike”; Ligjit Nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.162, datë 02.03.2016 “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, “Marrëveshjes së Mirëkuptimit Nr. 23/3 Prot, datë 09.09.2019 ndërmjet AIDA dhe

Al Shiddi Trading Company Ltd”, Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/7 datë 27.07.2020, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim te Agjencisë,

VLERËSOI:

- Projekti propozohet të realizohet nga Al Shiddi Trading Company LTD, shoqëri e së drejtës arabe, me numër regjistri themeltar 1010235319, me zyra qendrore në Riadh, Mbretëria e Arabisë Saudite, nëpërmjet subjektit Shiddi Group sh.p.k, shoqëri e regjistruar sipas të drejtës shqiptare NUIS/ NIPT L92202023J , me ortak të vetëm Al Shiddi Trading LTD.
- Projekti parashikon ndërtimin e një investimi kompleks dhe i përket pjesërisht sektorit strategjik të turizmit me strukturë akomoduese elitare turistike-hotel, apartamente elitare hotel, vila elitare Sky Village, strukturë mbështetëse turistike-qendër tregtare dhe garazh nëntokësor ashtu si dhe ndërtesë për zyra. Projekti i propozuar shtrihet në një sipërfaqe truall prej afërsisht 19,000 m2, në Zonën Kadastrale Nr. 8340, Tiranë.
- Vlera e investimit të projektit “TIRANA CITY CENTER” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 106,850,000 (njëqind e gjashtë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazës së realizimit të investimit dhe operimit, numri i të punësuarve parashikohet të jetë 1500 (njëmijë e pesëqind) persona.
- Subjekti propozues i projektit parashikon që, pas përfundimit të ndërtimit të projektit TCC, Qeverisë Shqiptare do t’i jepen 12 000 m2 ndërtim zyra (shell & core).
- Për këtë projekt, me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.23/2, datë 23.07.2019, në bazë të nenit 15 të Ligjit Nr.55/2015, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit Nr. 23/3 Prot, datë 09.09.2019 ndërmjet AIDA dhe Al Shiddi Trading Company LTD.
- Për këtë projekt, me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 2/7, datë 27.07.2020 është dhënë një afat 6 (gjashtë) mujor për plotësimin e parakushteve nga ana e subjektit të cilat lidhen kryesisht me dëshminë e disponimit të kapacitetit financiar në vlerën prej 20% të vlerës totale të investimit si dhe paraqitjen e dëshmimeve respektive mbi gjendjen gjyqësore e penale të subjektit për sa i përket aktivitetit tregtar.

- Me Vendim të KKT Nr.4, datë 14.10.2020, zona e Bulevardit të Ri të Tiranës, me sipërfaqe prej 21953.42 m², në ZK. 8340, Tiranë është shpallur “Zonë me Prioritet Zhvillimin e Turizmit”, në bazë dhe zbatim të dispozitave të legjislacionit të turizmit, dhe sipërfaqe e synuar për këtë projekt investimi i ka kaluar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në përgjegjësi administrimi, nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave.

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Parakushtet e vendosura me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/7, datë 27.07.2020, konsiderohen të plotësuara nga ana e subjektit dhe certifikimi i tyre të materializohet në preambulën e marrëveshjes për investim me investitorin, me nënshkrimin e deklaramit të plotësimit të parakushteve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
2. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” përfitohet nga subjekti aplikues dhe projekti i investimit “TIRANA CITY CENTER” për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
3. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike dhe legjislacionit të turizmit, masat mbështetëse që përfitohen janë ato të njëjta e të miratuara me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/7, datë 27.07.2020. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është organi përgjegjës për ndjekjen e procedurave ligjore për nënshkrimin e marrëveshjes së investimit me investitorin përfitues të statusit strategjik dhe vënien në dispozicion të pronës shtetërore për realizimin e investimit me qira simbolike 1 Euro për 99 vite.
4. Miratimi i projekt zbatimit duhet të jetë në përputhje me planin zhvillimor të Bulevardit të Ri, planet lokale dhe kombëtare të zhvillimit të territorit, ashtu si dhe strategjitë sektoriale.
5. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “TIRANA CITY CENTER” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

6. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për nënshkrim të deklarimit të plotësisimit të parakushteve në preambulën e marrëveshjes së investimit me investitorin.
8. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për ndjekjen e të gjitha procedurave për nënshkrimin e marrëveshjes së investimit me investitorin.
9. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për propozim në Këshillin e Ministrave të lidhjes së kontratës së përdorimit të pasurisë me çmimin simbolik 1 Euro.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA